



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

## KARTA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

#### Neni 1 Objekti i Kartës së Auditimit

Ky akt përcakton misionin, qëllimin, objektivat e punës dhe përgjegjësitë e funksionit të auditimit të brendshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të përcaktuara në përkufizimin, standartet ndërkombëtare të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe Kodin e Etikës, që drejtojnë praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

#### Neni 2 Baza ligjore

Kjo Kartë hartohet bazuar në nenet 12 e 14 të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e auditimit të brendshëm.

#### Neni 3 Përkufizime

Për qëllim të këtij akti termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Auditues i brendshëm: Është profesionisti i kualifikuar dhe i çertifikuar sipas kërkesave të ligjit për auditimin e brendshëm.
2. Autoriteti- Përcakton të drejtat e Auditimit të Brendshëm për të pasur akses në regjistrat dhe komunikim me stafin e njësisë.
3. Autoriteti i Auditimit ose Agjencia e Auditimit: AA\_është institucion publik buxhetor, strukturë e pavarur nga ana funksionale nga të gjithë aktorët e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të para-aderimit. Është përgjegjës për verifikimin e funksionimit me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, d.m.th. ai ka rolin e audituesit të jashtëm në sistemin e fondeve të BE-së
4. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm: (DAB) Strukturë e pavaruar nga pikpamja funksionale dhe organizative, funksionalisht brenda Ministrisë, që vlerëson sistemet e kontrollit të ngritura dhe kryen funksion këshillimor pranë Titullarit.

5. Karta e Auditimit: Është një akt administrativ që miratohet me urdhër të Titullarit të njësisë publike, në të cilën përcaktohen statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.
6. Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KA) Është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës i Titullarit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
7. Manual i auditimit: Është Manuali i Auditimit të Brendshëm i miratuar nga Ministria e Financave që përshkruan metodikën e punës së auditimit të brendshëm.
8. Njësi publike: Nënkupton njësitë e qeverisjes së përgjithëshme dhe çdo institucion tjetër që kryen funksione publike.
9. Standartet ndërkombëtare për auditimin e brendshëm: (IIA) Janë standartet ndërkombëtare për praktikat profesionale të audituesve të brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm.
10. Titullar i njësisë publike : Është kreu i organit qendror të njësisë publike, pra Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

## **KAPITULLI II**

### **MISIONI, QËLLIMI, FUSHA E VEPRIMIT DHE PARIMET E STANDARTET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

#### **Neni 4** **Misioni**

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për Titullarin, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

#### **Neni 5** **Qëllimi i auditimit të brendshëm**

Qëllimi kryesor i auditimit të brendshëm është të japë siguri objektive, të pavarur dhe aktivitet këshillimor, projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e njësisë publike. Ai ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

#### **Neni 6** **Objekti i Punës**

Objekti i punës së auditimit të brendshëm konsiston në:

- Identifikimin dhe vlerësimin e riskut, duke kontribuar në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut.
- Vlerësimin e kontrolleve të cilat adresojnë riskun.
- Inkurajimin e kontrolleve efektive dhe efçente dhe nxitjen për përmirësim të vazhdueshëm.
- Vlerësimin dhe pasqyrimin e procesit që siguron besueshmëri dhe integritet të informacionit financiar dhe operacional.
- Rekomandimin e përmirësimit të kontrolleve në ndihmë të procesit të qeverisjes.

## **Neni 7**

### **Fusha e veprimt**

Fusha e auditimit të brendshëm duhet të jetë mjaftueshëm e plotë për të mundësuar ekzaminimin efektiv dhe të rregullt të të gjithë veprimtarive operacionale, financiare dhe të lidhura, si dhe cilësinë e performancës për kryerjen e përgjegjësive të caktuara për të arritur qëllimet dhe objektivat e deklaruara të njësisë. Kjo përfshin:

- ❑ Vlerësimin e ekspozimit të riskut në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të njësisë.
- ❑ Vlerësimin e besueshmërisë dhe integritetin e informacionit dhe mjetet e përdorura për të identifikuar, matjen, klasifikimin, dhe për të raportuar një informacion të tillë.
- ❑ Vlerësimin e sistemeve të vendosura për të siguruar përputhjen me ato politika, plane, procedura, ligje dhe rregullore të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në njësinë.
- ❑ Vlerësimin e efektivitetit dhe efikasitetin me të cilën burimet janë përdorur.
- ❑ Vlerësimin e mjeteve dhe ruajtjen e pasurisë sipas nevojës, verifikimin e ekzistencës së aktiveve të tilla.
- ❑ Vlerësimin e operacioneve apo programeve për të vërtetuar nëse rezultatet janë në përputhje me objektivat dhe synimet e vendosura, dhe nëse operacionet ose programet janë duke u kryer siç janë planifikuar.
- ❑ Kryerjen e konsultimit dhe shërbimeve këshilluese në lidhje me menaxhimin e riskut dhe kontrollin, si objektiva të përshtatshme për njësinë.
- ❑ Raportimin periodik për veprimtarinë e auditimit të brendshëm, mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe performancën në lidhje me planin e tij.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm udhëhiqet vetëm nga respektimi i udhëzimeve të detyrueshme, përfshirë Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës, si dhe Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë.

Përveç kësaj, veprimtaria e auditimit të brendshëm i përmbahet, politikave, procedurave dhe metodave të auditimit, si pjesë e manualit standart të auditimit të brendshëm.

## **Neni 8**

### **Parimet e përgjithshme të funksionimit të auditimit të brendshëm**

Funksioni i auditimit të brendshëm ka status të pavarur në dhënien e opinionëve dhe rekomandimeve. Ai udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, profesionalizmit, kompetencës dhe konfidencialitetit, paanësisë, pavarësisë. Veprimtaria e auditimit është e lirë nga ndërhyrjet nga çdo element tjetër në njësinë publike duke përfshirë edhe çështjet në zgjedhjen e auditimit, fushë veprimin, procedurat, frekuencën, kohën apo përmbajtjen e raportit, të cilat lejojnë mbajtjen e një qëndrimi të pavarur dhe objektiv.

Për të realizuar pavarësinë strukturat e auditimit të brendshëm duhet:

- ❑ Të jenë funksionalisht përgjegjës mbi baza të përherëshme.
- ❑ Të mos kenë fuqi, pushtet ekzekutiv apo menaxherial, autoritet, funksione apo detyra përveç atyre që lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm.
- ❑ Të mos jenë përgjegjës për zhvillimin apo implementimin e detajuar të sistemeve të reja, por mund të japin këshillime para dhe pas zhvillimeve të tilla.
- ❑ Të mos përfshihen në sistemin e kontrollit operativ dhe në veprimtari operative brenda subjektit publik.

Pavarësia e audituesve të brendshëm të caktuar në një auditim duhet të garantohet në përputhje me Standartet profesionale. Për të siguruar pajtueshmërinë me këto Standarte, Audituesit e Brendshëm deklarojnë paraprakisht pavarësinë e tyre duke plotësuar deklaratën e pavarësisë.

#### **Neni 9**

#### **Standartet e auditimit të brendshëm.**

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në MPJ kryhet në përputhje me:

- Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave;
- Ligjin për Auditimin e Brendshëm në njësitë publike dhe të gjitha aktet nënligjore bazuar në këtë ligj;
- Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe akte të tjera specifike për kryerjen e shërbimit të auditimit.

### **KAPITULLI III**

#### **STATUSI ORGANIZATIV**

#### **Neni 10**

#### **Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MEPJ**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MEPJ në zbatim të ligjit është një strukturë e pavarur funksionalisht brenda ekzekutivit, por jashtë strukturave operative.

DAB është një njësi që varet nga Titullari i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe si strukturë harmonizimi dhe raportimi ka edhe strukturën përgjegjëse për harmonizimin e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Drejtuesi i Drejtorisë së Auditimit raporton drejtpërdrejt tek Titullari i Ministrisë.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka një status organizativ të përbërë nga Drejtori dhe katër specialistë.

#### **Neni 11**

#### **Komiteti i Auditimit të Brendshëm**

Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillimor i Titullarit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe mbështetës për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në realizimin e funksioneve të auditimit të brendshëm në njësinë publike. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Funksionet kryesore të këtij komiteti janë:

- Të japë këshilla për Titullarin në mbështetje të Drejtorit të Auditimit të Brendshëm në të gjitha aspektet e planeve të punës, praktikave të auditimit, cilësinë etj. Ai i jep Titullarit garanci të arsyeshme mbi mënyrën e funksionimit të njësisë publike.
- Të japë mendim paraprakisht mbi planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit të brendshëm për t'ja paraqitur atë Titullarit për aprovim përfundimtar.

- ❑ Shqyrton dhe vlerëson performancën e auditimit të brendshëm në njësinë publike dhe siguron që nuk ka kufizime mbi auditimin nga menaxhimi.
- ❑ Shqyrton dhe vlerëson çdo akt tjetër që lidhet me sigurimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë së auditimit në njësinë publike.
- ❑ Monitoron raportet e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm drejtuar Titullarit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit të brendshëm.
- ❑ Jep opinion për Titullarin e njësisë publike, mbi mosmarrëveshjet ndërmjet palës së audituar dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

## **KAPITULLI IV**

### **TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

#### **Neni 12 Autoriteti**

Kryerja e auditimit është subjekt aprovimi nga Titullari i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe drejtuesi i Drejtorisë së Auditimit. Titullari miraton planet vjetore të auditimit sipas mënyrave të përcaktuara me ligj, ndërsa drejtuesi i Drejtorisë së auditimit të brendshëm miraton programet e auditimit të subjekteve që do të auditohen sipas planit të miratuar. Ekzekutivi duhet t'i sigurojë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm burimet e nevojshme lidhur me stafin dhe kushtet të tjera të nevojshme për të realizuar auditime të pavarura dhe me cilësi.

Me urdhër të Titullarit, Drejtoria e Auditimit kryen auditime të plota ose për sisteme të veçanta kontrolli edhe jashtë planit vjetor të miratuar.

#### Auditimi i brendshëm ka autoritetin:

- ❑ Të kryejë auditime në pajtim me programin e aprovuar.
- ❑ Të ketë akses në të gjitha periudhat e veprimtarisë së subjektit dhe në të gjithë rregjistrat, dokumentat, llogaritë, korrespondencën, asetet fizike dhe të dhëna të tjera të subjektit që ai i çmon të nevojshme për kryerjen e procesit të auditimit.
- ❑ Të kërkojë informacion nga çdo i punësuar i subjektit që auditohet kur gjykohet se një gjë e tillë duhet për të forcuar një opinion mbi ndershmërinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit.
- ❑ Gëzon prioritet nga menaxhimi i të gjitha niveleve për diskutime relevante me çështje që lidhen me auditimin e subjektit.

#### Kufizimet

Drejtuesi i Drejtorisë së Auditimit dhe stafi i auditimit nuk janë të autorizuar:

- ❑ Të kryejnë ndonjë detyrë operative për MPJ ose strukturë vartëse të saj.
- ❑ Të mbajnë mandate politike apo të jenë të zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat politike.
- ❑ Të krijojnë ose të miratojnë transaksione të llogarisë që janë jashtë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.
- ❑ Të drejtojnë veprimtarinë e punonjësve që nuk janë të punësuar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, përveç rasteve kur këta punonjës janë caktuar në grupet e auditimit sipas nevojës, ose në ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar audituesit e brendshëm.

### **Neni 13** **Përgjegjësitë**

Drejtuessi i Drejtorisë së AB-së është përgjegjës për të siguruar:

- ❑ Organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin;
- ❑ Hartimin e Kartës së Auditimit, akteve të tjera specifike për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, si dhe dërgimin e tyre për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm;
- ❑ Hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga Titullari i njësisë publike;
- ❑ Përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm
- ❑ Raportimin menjëherë në formë të shkruar tek Titullari i njësisë publike, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e DAB-së përbëjnë vepër penale.

Përgjegjësi i Grupit të Auditimit mbikëqyr punën audituese në mënyrë që të sigurohet se audituesit marrin mbështetjen e nevojshme; burimet e auditimit përdoren me dobi, frytshmëri dhe kursim dhe se auditimi kryhet:

- a) sipas planit të miratuar;
- b) në përputhje me metodologjinë dhe Standartet e përcaktuara;
- c) në nivel të përshtatshëm menaxhimi ose procesi të njësisë;
- d) duke diskutuar me audituesit mbi mënyrat më efikente për punën audituese dhe përgatitjen e rekomandimeve.

Për çështje të rëndësishme, Përgjegjësi i Grupit i jep audituesit detyra me shkrim.

Nëse sipas gjykimit të Përgjegjësit të Grupit kërkohet të bëhet një shmangie nga Plani i auditimit, kjo duhet të diskutohet me Drejtuesin Drejtorisë së Auditimit, të dokumentohet dhe të miratohet.

Përgjegjësitë e audituesve janë:

- ❑ Të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit të brendshëm;
- ❑ Të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;
- ❑ Të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;
- ❑ Të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- ❑ Të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;
- ❑ Të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit;
- ❑ Të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre nga personat përgjegjës dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes;
- ❑ Të raportojnë menjëherë tek drejtuesi i DAB-së kur zbulohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale.

Stafi auditues duhet të diskutojë çështjet e auditimit me Përgjegjësin e Grupit në mënyrë jo-formale, për ta bërë me dije mbi përmbushjen e programit të auditimit, pengesat, çështjet e dala si dhe nevojat e audituesve deri në përfundim të punës audituese. Për auditime të rëndësishme, ky informim bëhet nëpërmjet raporteve të ndërmjetme.

## **KAPITULLI V METODIKA E AUDITIMIT**

### **Neni 14**

#### **Plani i auditimit të brendshëm**

- Në konsultim paraprak me menaxhimin e lartë dhe Komitetin e Auditimit, drejtuesi i DAB, çdo vit, paraqet pranë Titullarit një plan auditimi të brendshëm për shqyrtim dhe miratim. Plani i auditimit të brendshëm jep një informacion mbi punën që do të kryejë auditimi gjatë një viti, dhe përfshin kërkesat për buxhetin dhe burimet që do të përdoren gjatë vitit të ardhshëm kalendarik.
- Drejtuesi i DAB komunikon ndikimin e kufizimeve të burimeve, si dhe ndryshimet e rëndësishme të planit i prezanton tek Titullari dhe Komiteti i Auditimit.
- Plani i auditimit të brendshëm zhvillohet në bazë të prioritetit të universit të auditimit, duke përdorur një metodologji që bazohet në vlerësimin e riskut, duke përfshirë edhe kontributin e menaxhimit të lartë dhe KA.
- Drejtuesi i DAB, shqyrton dhe rregullon planin, sipas nevojës, në përgjigje të ndryshimeve të aktivitetit të njësisë, risqeve, operacioneve, programeve, sistemeve dhe kontrolleve. Çdo devijim i rëndësishëm nga plani i aprovuar i auditimit të brendshëm bëhet me miratim të Titullarit dhe Komitetit të Auditimit përmes veprimtarisë raportuese periodike.

### **Neni 15**

#### **Raportimi dhe monitorimi**

- Në përfundim të çdo angazhimi përgatitet një raport i shkruar auditimi, i cili i dërgohet subjektit të audituar.
- Raporti i auditimit prezanton fushën e auditimit, kufizimet eventuale, zbulimet dhe konkluzionet në mënyrë objektive si dhe të bën rekomandimet përkatëse kur është e nevojshme.
- Auditimi i brendshëm ka një status raportimi të pavarur brenda subjektit çka presupozon që raportet e tij i përcillen drejtpërdrejt tek Titullari.
- Për auditimet e kryera për fondet IPA përveç Titullarit të Ministrisë duhet të raportohet paralelisht edhe tek Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO).
- Rezultatet e auditimit të brendshëm duhet t'i komunikohen Komitetit të Auditimit periodikisht.
- Drejtorja e Auditimit të Brendshëm është përgjegjëse për raportimin e të gjitha gjetjeve gjatë angazhimit tek titullari i njësisë dhe titullari i MEPJ-së dhe të raportojë zbatimin e rekomandimeve nga subjekti i audituar apo strukturat e ngarkuara nga titullari për zbatimin e këtyre rekomandimeve.
- Raporti i auditimit të brendshëm përfshin përgjigjet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra nga menaxhimi i subjektit të audituar ose që do të merren në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet specifike.
- Drejtuesi i DAB-së raporton periodikisht tek Titullari dhe Komiteti i Auditimit, mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm, përgjegjësitë, si dhe performancën e saj. Raportimi përfshin ekspozimet ndaj risqeve dhe çështjeve të kontrollit, duke përfshirë edhe

risqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes, si dhe çështje të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga Titullari dhe Komiteti i Auditimit.

#### **Neni 16**

##### **Ndjekja e rekomandimeve**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm DAB harton procesin e ndjekjes së rekomandimeve për të monitoruar dhe për t'u siguruar që veprimet korrektive janë implementuar dhe janë efektive.

Gjithashtu DAB i jep rekomandime titullarit për adresimin në strukturat përkatëse brenda MEPJ-së të rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të kontrollit që nuk varen nga subjekti i audituar dhe bën ndjekjen e zbatimit të tyre.

Titullari i subjektit të audituar është përgjegjës për të vlerësuar domosdoshmërinë e veprimeve korrektive që duhet të ndërmerren për zbatimin e rekomandimeve për dobësitë e zbuluara. Ai duhet të njoftojë me shkrim DAB brenda 30 ditëve nga njohja me raportin përfundimtar të auditimit, lidhur me pranimin dhe masat konkrete të marra për zbatimin e tyre.

DAB bën vlerësimin dhe verifikimin e përgjigjeve të titullarit të subjektit të audituar si dhe informon titullarin e MEPJ-së periodikisht për përgjigjet e marra apo pranimin e rikut nga njësia e audituar.

Të gjitha gjetjet e rëndësishme do të mbahen në një skedar si çështje të hapura derisa ato të zbatohen plotësisht.

#### **Neni 17**

##### **Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm do të mbajë një program të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit që mbulon të gjitha aspektet e aktivitetit të auditimit të brendshëm, i cili miratohet me urdhër të titullarit të MEPJ-së. Programi do të përfshijë një vlerësim të konformitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm me përkufizimin e Auditimit të Brendshëm dhe Standardeve dhe një vlerësim nëse audituesit e brendshëm zbatojnë Kodin e Etikës. Programi gjithashtu vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Drejtuesi i DAB-së komunikon me Titullarin dhe Komitetin e Auditimit, lidhur me implementimin e programit dhe sigurimin e cilësisë, duke përfshirë rezultatet e vlerësimit e vazhdueshme të brendshme dhe vlerësime të jashtme, të cilat duhet të kryhen të paktën një herë në çdo 5 vjet.

### **KAPITULLI VI**

#### **BASHKËPUNIMI I BRENDSHËM DHE NDËR-INSTITUCIONAL**

#### **Neni 18**

##### **Marrëdhëniet midis auditimit të brendshëm dhe të jashtëm që marrin pjesë në Instrumentin e para-aderimit (IPA)**

DAB në MEPJ bashkëpunon me audituesit e jashtëm për fondet IPA dhe është subjekt auditimi i këtyre institucioneve:



- Autoriteti Kombëtar i Auditimit (Agjencia e Auditimit)
- Kontrolli i Lartë i Shtetit,
- Komisioni Evropian
- Gjykata Evropiane e Audituesve.

Fushat kryesore të bashkëpunimit janë:

- bashkërendimi i mirë midis autoriteteve të auditimit dhe strukturave të tjera në fazën e planifikimit, si edhe gjatë zbatimit të planeve të auditimit;
- shkëmbim dhe përdorim i gjetjeve të auditimit si nga autoritetet e auditimit edhe nga strukturat e tjera audituese.
- takime të rregullta midis autoriteteve të auditimit dhe strukturave të tjera audituese.
- kur është e përshtatshme, si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, Agjencia e Auditimit mund të mbështetet në punën e audituesve të brendshëm dhe mund të zbatohet "koncepti i një auditimi të vetëm", kjo me qëllim përdorimin sa më të mirë dhe efikas të burimeve të auditimit dhe i uljes së përgjegjësisë ndaj njësisë që auditohet duke shmangur mbivendosjet e veprimtarive audituese.
- Agjencia e Auditimit ka të drejtë të kërkojë detajet e punës së kryer nga auditimi i brendshëm, përfshirë raportet dhe dosjet e auditimit të brendshëm në çdo njësi të auditimit të brendshëm që është e përfshirë në auditimin e fondeve IPA.

## **Neni 19**

### **Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm bashkëpunon me Kontrollin e Lartë të Shtetit bazuar në parimet e komunikimit të vazhdueshëm, angazhimit, mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë. Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të mbështetet në punën e auditimit të brendshëm.

Fushat kryesore të bashkëpunimit janë:

- shkëmbimi i planit të konsoliduar të auditimit, me synim shmangien e mbivendosjeve;
- shkëmbimi i informacionit dhe i raporteve të auditimit;
- zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe trajnimi i përbashkët.

## **Neni 20**

### **Marrëdhëniet me Inspektimin Financiar**

Një nga përgjegjësitë e audituesve të brendshëm është të raportojnë menjëherë te drejtuesi i DAB-së kur zbulohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e tyre, përbëjnë vepër penale. Drejtuesi i DAB-së do të raportojë me shkrim tek Titullari i MEPJ-së, i cili vendos për dërgimin e raportit të auditimit pranë strukturës së inspektimit financiar, për vijimin e procedurave.

Inspektimi Financiar Publik pasi të analizojë këto informacione njofton Nëpunësin Autorizues për fillimin ose jo të procedurës së inspektimit financiar publik ose do të vendosë për kryerjen e një inspektimi paraprak të çështjes së raportuar.

## **Neni 21**

### **Marrëdhëniet me strukturën përgjegjëse të harmonizimit të AB**

Drejtuesi i DAB mban kontakte të rregullta me strukturën përgjegjëse të harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Në funksion të bashkërendimit të punës, ky bashkëpunim konsiston në:

- Dërgimin e planit vjetor të auditimit si dhe ndryshimet e bëra në këtë plan gjatë vitit, të cilat reflektohen në planin vjetor të konsoliduar për veprimtarinë dhe funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në shkallë vendi.
- Dërgimin e një raporti vjetor për funksionimin e auditimit të brendshëm.
- Koordinimin në lidhje me trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm të audituesve të organizuara nga kjo strukturë.

## **Neni 22**

### **Marrëdhëniet me Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KA)**

Drejtuesi i DAB-së siguron kontakte të rregullta me Komitetin e Auditimit. DAB i dorëzon KA-së të gjitha dokumentet e nevojshme për marrjen e opinionit/aprovimit të tij dhe informacionin e kërkuar shtesë, merr reagimet nga KA dhe e informon KA-në për çdo rast të cënimit të pavarësisë të DAB-së nga menaxherët, operacionet e të cilëve janë duke u audituar. Roli i Komitetit të Auditimit rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 23**

### **Dispozita të fundit**

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.